



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic Kosovo



Komuna e Istogut  
Opština Istog  
Municipality of Istog

00 Nr. 64/ 2024

30.04.2024

Komuna e Istogut përmes grupit punues për Hartimin e Draft - Planit Lokal të Veprimit për barazi gjinore (2024-2027), duke u bazuar në ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2018) dhe Statutin e Komunës 01 Nr.62/-010 të miratuar me datën 30.11.2010 dhe Nenit 5 pika 2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/202023 për Administratë të Hapur në Komunë, Komuna lëshon këtë:

**NJOFTIM  
PËR  
KONSULTIM PUBLIK**

**Draft- Plani Lokal i Veprimit për barazi gjinore 2024-2027**

Ky dokument do të jetë në Konsultim Publik nga data **30.04.2024** deri më datën **30.05.2024**, ndërsa Konsultimi Publik me qytetarë do të mbahet me datë **16.05.2024**, në sallën e Kuvendit Komunal të Istogut e cila gjendet në objektin e Komunës kati i III, me fillim në ora **11:00**.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund ti dërgoni deri me datën **30.05.2024** në ora **16:00**, tek ardon.arifaj@rks-gov.net ose info.istog@rks-gov.net

Me qëllim që qytetarët të njihen rreth këtyre dokumenteve, Komuna e Istogut, konkretisht Zyra për Informim ka publikuar këtë propozim dokument në ueb faqen zyrtare të Komunës së Istogut, <https://kk.rks-gov.net/istog/category/konsultimetpublike/> në rubrikën Konsultimet Publike.

Këto diskutime publike janë të hapur për të gjithë qytetarët e Istogut, duke përfshirë shoqërinë civile, profesionistët dhe ekspertët e fushave relevante, andaj ftoheni të gjithë pa dallim të merrni pjesë në Diskutim Publik.

*Ju mirëpresim!*

Drejtori për Administratë Komunale

Z. Arben Kabashi

